



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:235160

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06225666

C.nr.3837/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Njomëza Berisha, me bashkëpunëtorin profesional J.N. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit M.K. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat, B.Sh. nga Prishtina, kundër të paditurës M.A.Sh.T- Sekretariati i Përgjithshëm dhe A.A.A.P.Rr. me objekt kontesti kompensim i pagave për shpërblim jubilar, vlera e kontestit 1.415.00 euro, jashtë seance, me datë 30.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit M.K. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të “ *Aprovohet kërkesëpadia e paditësit, ashtu që të detyrohet e paditura M.A.Sh.T.- Sekretariati i Përgjithshëm dhe A.A.A.P.Rr. që paditësit ti paguaj borxhin në emër të tri pagave për shpërblim jubilar dhe në shumën e përgjithshme prej 1.415.00 euro së bashku me kamatën ligjore prej 8 % në vit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm të këtij aktgjykimi.*”
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

A r s y e t i m

Paditësi M.K., nga Prizreni, përmes të autorizuari të tij, pranë kësaj gjykate me datën 10.11.2022, kundër të paditurës M.A.Sh.T.- Sekretariati i Përgjithshëm dhe A.A.A.P.Rr. me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit jubilar.

I autorizuari i paditësit, në padi ka theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie të e paditura deri në ditën e pensionimit. Pas pensionimit paditësit i ka takuar pagë jubilarë (tri) si dhe e drejta për shpërblim jubilar. Prandaj gjykatës i ka propozuar, që e njëjta të merr aktgjykim dhe padinë e kërkesëpadinë e paditësit, ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe të detyroj të paditurën që paditësit të ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 1415.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, prej ditës së paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura M.A.Sh.T, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe e kundërshton në tersi, gjithashtu thekson se kërkesë padi e paditësit është parashkuar siç është përcaktuar me Ligjin e Punës nenin 87 Afati i parashkrimit të gjitha

kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda 3 viteve nga dita e paraqitjes së kërkesës. Në anën tjetër ka theksuar se kërkesa është në kundërshtim me Kontratën Kolektive të datës 18.04.2017 sepse e njëjta është shfuqizuar dhe me Kontratën Kolektive të datës 21.11.2022 sepse MASHT është tërhequr nga kjo kontratë dhe si e tillë kjo kontratë nuk mund të gjen zbatim andaj, në fund ka kërkuar nga gjykata, që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat të dorëzuara me padinë si në vijim: vërtetimin me numër të referencës 19/30, të datës 08.03.2011 dhe vërtetimin me numër të protokollit 133/2018 të datës 24.10.2018.

Gjykata pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 399, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqësve nuk ishte kontestues fakti se paditësi ishte në marrëdhënie punë tek e paditura, përkatësisht fillimisht në SHFMU “Nazim Buduri” Hoqë e Qytetit, Prizren, që nga data 24.10.1972, deri me 01.09.1973, pastaj nga data 31.08.1973, deri me datë 31.08.1980 dhe nga data 01.09.1981, deri me 10.10.1981, apo gjithsej 9 vite përvojë pune, si dhe pranë Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” në Prizren, që nga data 11.10.1981 deri me datë 31.08.1983, prej datës 23.09.1983 deri me datë 01.03.1991, prej 02.03.1991 deri me 14.03.2000 dhe prej 09.09.2008 deri me 28.05.2016 përkatësisht, paditësi i ka gjithsej 26 vite, përvojë pune pranë të paditurës, ndërsa përvoja e përgjithshme duke përfshirë edhe shkollën paraprake është 35 vite. Kjo u vërtetua nga vërtetimet e lëshuara nga institucionet arsimore ku paditësi ka punuar e të cilat i janë bashkangjitur padisë. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet për arsye si në vijim:

Paditësi me padinë e tij ka kërkuar kompensimin e tri pagave jubilarë. Gjykata bazuar në të lartcekurat ka vërtetuar faktin se paditësi M.K. ishte në marrëdhënie pune pranë të paditurës në vendin e punës si mësimdhënës, drejtor, edukator dhe mësues udhëtues, pranë SHFMU “Nazim Buduri” dhe pranë Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nëna Terezë” në Prizren dhe i njëjti gjithsej ka 35 vite përvojë pune, ndërsa me datë 28.05.2016, i njëjti është pensionuar. Gjykata vlerëson se paditësi 30 vite të përvojës së punës për të cilën e kërkon kompensimin e tri pagave jubilarë sipas përlllogaritjes së gjykatës e ka arritur në vitin 2011, në kohën kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, nuk ka qenë në fuqi, pra gjykata vlerëson se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, e cila aplikohet për periudhën kohore (01.01.2015-31.12.2017), nuk ka veprim retroaktiv për vitin 2011, përkatësisht në kohën e arritjes së 30 vite të përvojës së punës të këtu paditësit. Po ashtu duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik, për shpërblimin jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 27.02.2023, në

pikë II përcaktohet që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, aplikohet për periudhën kohore nga data 01.01.2015 - 31.12.2017. Në bazë të lartcekurave gjykata konstaton se paditësi në Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, (01.01.2015-31.12.2017) nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi ka mbushur 30 vite të përvojës së punës dhe për këtë arsye kërkesëpadia e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në anën tjetër gjykata konstaton se edhe nëse kjo e drejtë do ti njihet paditësit në bazë Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, e vlefshme për periudhën kohore nga data 01.01.2015 - 31.12.2017, kjo kërkesë edhe në atë rast është e pabazuar sepse kjo e drejtë do të ishte bërë e arritshme me datë 01.01.2015 ndërsa padia është parashtruar në gjykatë me datë 10.11.2022, pra pas kalimit të afatit 3 vjeçar dhe si e tillë kjo kërkesë është e parashkruar.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, ku është obliguar që secila palë ti bartë shpenzimet e veta, sepse pala e paditur si gjyqfituese nuk i ka kërkuar.

Nga arsyet e cekura me lart dhe bazuar në dispozitat e nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.3837/2022, datë 30.09.2024

B. Profesional
Jeton Nezaj

Gjyqtarja
Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.